



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:015449

Datë: 17.03.2021

Numri i dokumentit: 01605908

PKR.nr. 163/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMLELORE NË PEJË – Departamenti për krime të Rënda – Kryetari i trupit gjykues Sami Sharaxhiu ,me pjesëmarrjen e sekretares juridike Lulavere Mala, në çështjen penale kundër të akuzuarve Z. P. nga fsh. K., dhe atë për shkak të veprës penale, të kanosjes nga neni 181 par. 4 lidhure me par, 2. të KPRK-së, si dhe vepra penale , mbajtja në pronësi , kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, si dhe i akuzuari F. P. nga fsh. K., për shkak të veprës penale, Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 par.1. nën par. 1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTHDP në Pejë, e përfaqësuar nga PTHDKR në Pejë, PP/II-nr. 2445/19 të datës 31.01.2020, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur në prezencën e prokurorit të shtetit Haxhi Sinanaj, të akuzuarve Z. P. dhe F. P. , me datë 16.03.2021, muarr dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 17.03.2021, përpiloi këtë :

A K T G J Y K I M

TË AKUZUARIT

Z. P. i lindur me dt. në fsh. K., ku edhe jeton, i biri i A. dhe N. e gjinisë Ll. , i martuar – baba i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar në bazë të Inj. Nr. posedon tel. nr., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës , gjendet në liri.

F. P. , i lindur me datën, në fsh. K., ku edhe jeton, i biri i H. dhe H. e gjinisë D. , i martuar – baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon tel nr., i identifikuar në bazë të Inj. Nr., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

JANË FAJTOR

Për shkak se:

I akuzuari Zekë Povataj:

I.Me datë 27.09.2019, rrethe orës 23:00 në rr.” “, me armë seriozisht i kanoset personit tjetër me fjalë dhe gjeste se do ta dëmtoj me armë zjarri dhe privoi nga jeta dhe atë të

dëmtuarit F. P. , në atë mënyrë që , pas një mosmarrëveshje që kishin ndërmjet vete i dëmtuari me të pandehurin, ky i fundit shkon në shtëpinë e tij e merr një pistoletë me gazë të tipit BLOW TR-34P.A.K. kali. 9 mm, me një taxi kthehet tek i dëmtuari F. në vendin e lartcekur dhe i'a drejton këtë pistoletë dhe i thotë fjalët “a e din çka muj me të ba juve me këtë armë , ju vras ...”, për çka tek i njëjti shkakton frikë dhe panik,

- me çka ka kryer veprë penale “kanosjes nga neni 181 par.,4. lidhur me par.2. të KPRK-së.

II. Në kohë të panjohur e gjerë me datën 27.09.2019, rrethe orës 23:00,min, në , në rr. “..... “, në kundërshtim me nenin 5 par.1. të Ligjit mbi armën mban në pronësi dhe kontroll armë, në atë mënyrë që i njëjti në kohë të panjohur, pa leje merr në posedim një pistoletë me gazë të tipit BLOW-TR-34 P.A.K. kal 9 mm, me numër serik B0413-17020024 dhe një karikator të kësaj arme , të cilën e posedon deri me datën 17.10.2019 kur edhe e kryen veprën penale të përshkruar sikur në dispozitivin e parë .

- Me çka ka kryer veprë penale “mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

I akuzuari Fatmir Povataj:

III. Me datë 27.09.2019, rreth orës 23:00, në rr. “.....”, tjetrit i shkakton lëndime të lehta trupore me pasojë dëmtimi i përkohshëm i shëndetit dhe atë të dëmtuarit Z. P. , në atë mënyrë që, pas fjalosje mes të dëmtuarit dhe të pandehurit lidhur me atë se si i dëmtuari Z. ishte futur në veturën e të pandehurit , ky i fundit e godet me grusht në syrin e majtë njëherë të dëmtuarit të të cilit i shkakton lëndime të lehta trupore,

- me çka ka kryer veprë penale , ”Lëndim i lehtë trupor” nga neni 185 part.1. nën par.1.4 të KPRK-së.

Andaj, gjykata, konform nenit 2, 4 par.1 nën par 1.1 ,1.2 dhe 1.3, neni 7, 8, 38, 39 par.1. nën par1.1, 1.2 dhe 1.3 nenit 40 par.1. nën par.1.3, nenit 46 par.1. nën par.1.1, nenit 47 , 48, 49, 181 par.4 lidhur me par.2, nenit 366 par.1, nenit 185 par.1. nënpar.1.4 , si dhe nenit 366 par.3. të KPRK-së, të akuzuarit secilin veç e veç i gjykon:

Të akuzuarin Z. P. gjykata e gjykon:

Për veprën penale nga pika I e dispozitivit të aktakuzës, gjykata ia shqipton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve.

Për veprën penale nga pika II e dispozitivit të aktakuzës, gjykata ia shqipton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve ,

Konform nenit 76 par.1. dhe 2, nën par.2.2 të KPRK-së, gjykata të akuzuarit i shqipton :

DËNIM UNIK ME KUSHT

Ashtu që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej **9 (nëntë) muajve** e të cilin dënim i akuzuari nuk do ta vuaj nëse në afat prej **1 (një) viti** nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor, gjykatës të ia paguaj shumën prej **25 € (njëzet e pesë)euro**, ndërsa lirohet nga paguarja e taksës për kompensimin e viktimave të krimit.

Konform nenit 366 par.3. të KPRK-së, të akuzuarit i shqiptohet edhe dënimi plotësues me të cilin dënim, pistoleta me gaz, e tipit BLOW TR-34 P.A.K kalibër 9 mm, me numër serik B0413-17020024, dhe një karikator i kësaj arme, konfiskohen dhe urdhërohet që e njëjta pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të shkatërrohet.

Të akuzuarin F. P. , gjykata e gjykon me :

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që ia përcakton dënimin me gjobë në shumë prej **150 € (njëqind e pesëdhjetë euro)**, e të cilin dënim me gjobë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në afat prej **30 ditësh** pasi që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm, e po që se nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, dënimi me gjobë i zëvendësohet me dënim me burg e ku një ditë burgu i llogaritet në shumë prej 20 €.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor , gjykatës të ia paguaj shumën prej **25 € (njëzet e pesë euro)**, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave shumën prej **50 € (pesëdhjetë euro)**, e të gjitha këto në afat prej **15 ditësh** pasi që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm.

A r s y e t i m

PTHDP në Pejë , tani e përfaqësuar nga PTHDKR në Pejë, ka ngritur aktakuzë, ndaj të akuzuarve Z. P. nga fsh. K., dhe atë për shkak të veprës penale, të kanosjes nga neni 181 par. 4 lidhure me par, 2. të KPRK-së, si dhe vepra penale , mbajtja në pronësi , kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, si dhe të akuzuarit F. P. nga fsh. K., për shkak të veprës penale, Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 par.1. nën par. 1.4 të KPRK-së, me propozim që të mbahet shqyrtimi gjyqësor dhe pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të akuzuarit të shpallen fajtor, të dënohet sipas ligjit dhe të obligohen në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale si dhe të akuzuarit Z. P. të i shqiptohet edhe dënimi plotësues me të cilin i konfiskohet arma me të cilën është kryer vepra penale dhe e njëjta pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të urdhërohet që të shkatërrohet.

Të akuzuarit secili veç e veç , në shqyrtimin fillestar të datës 16.03.2021, e kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen dhe këtë veprim e kanë bërë në baza vullnetare dhe të pa ndikuar nga askush .

Prokurori i shtetit Haxhi Sinanaj, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve secili veç e veç , ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, e i cili pranim është bërë në mënyrë vullnetare dhe është në përputhje me provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Meqenëse të akuzuarit secili veç e veç, e kanë pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar, gjykata me rastin e vlerësimit të pranimit të fajësisë ka ardhur në përfundim se janë përmbushur të gjitha kushte që burojnë nga neni 248 të KPPRK-së, andaj edhe e ka aprovuar pranimin e fajësisë si të bazuar.

Meqenëse, të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë, gjykata fare nuk është lëshuar në procedurë të provave por duke u nisur nga pranimi i fajësisë si dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës , ka

ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit Z. P. , ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale të kanosjes, nga neni 181 par.4 lidhur me par. 2 të KPRK-së, si dhe veprës penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 pa.1. të KPRK-së, ndërsa në veprimet e të akuzuarit F. P. , ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale, lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 par.1. nën par.1.4 të KPRK-së, dhe njëherit gjykata, para se të kaloi në marrjen e vendimit mbi dënimin i ka ftuar palët në procedurë që të deklarohen lidhur me dënimin.

Prokurori i shtetit lidhur me dënimin ka deklaruar se i propozon gjykatës që të pandehurit të shpalle fajtor, të dënohen sipas ligjit dhe të obligohen në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale dhe të shqiptohet dënimi plotësues konfiskimi i armës, njëkohësisht pas plotfuqishmëri së aktgjykimit gjykata të lëshoi urdhëresë për konfiskimin dhe shkatërrimit e armës së sekuestruar.

I akuzuari Z. P. lidhur me dënimin ka deklaruar se me vjen keq për rastin e ndodhur njëherit arma të cilin e kam poseduar ka qenë me gazë, dhe vullnetarisht e kam dorëzuar ndërsa me F. jemi djemtë e axhës dhe jemi pajtuar andaj kërkoi nga gjykata që mundësisht të ma shqiptoi një dënim sa më të butë sepse i vetmi burim është pensioni i veteranit të luftës.

I akuzuari F. P. lidhur me dënimin ka deklaruar se më vjen keq për rastin e ndodhur , me Z. jemi djemtë e axhës dhe jemi pajtuar , kërkoi nga gjykata që këto rrethana të i marr si rrethana lehtësuese dhe të ma jap një dënim sa më të butë.

Gjykata, me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, konform nenit 69 dhe 71 të KPRK-së, i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese, si rrethanë lehtësuese gjykata mori për bazë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve secili veç e veç, pajtimin në mes të dy të akuzuarve të cilët në mes veti janë familjar, sjelljen e mirë të tyre në gjykatë, si dhe pendimin e sinqertë të shprehur në gjykatë dhe faktin se të njëjtit nuk janë të njohur për organet e drejtësisë si kryes të veprave penale në të kaluarën ndërsa, gjykata rrethana rënduese nuk gjeti dhe për këtë arsye të akuzuarve iu shqiptoi dënimin sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi e bindur thellësisht se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i sanksionit penal dhe të pandehurit do të parandalohen që në të ardhmen të kryejnë ndonjë veprë tjetër penale.

Gjykata, të akuzuarit secili veç e veç i ka udhëzuar në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale , konform nenit 450 par.1. dhe 2, të KPRK-së, ndërsa të akuzuarin F. edhe n paguarjen e taksës për kompensimin e viktimave të krimit konform ligjit nr. 05/L-036 , gjersa të akuzuarin Z., e ka liruar nga paguarja e taksës për kompensimin e viktimave të krimit ngase i njëjti gjykatës ia ka prezantuar librezën e veteranit të luftës gjegjësisht i njëjti është shfrytëzues i pensionit të veteranit të luftës .

Gjykata, konform nenit 366 par.3, të KPRK-së, të akuzuarit Z. P., ia ka shqiptuar edhe dënimin plotësues me të cilin arma me të cilën është kryer vepra penale , është konfiskuar dhe është urdhëruar që e njëjta pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit e njëjta të shkatërrohet.

Andaj, nga sa u tha më lartë është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELOR NË PEJË Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr. 163/20 e datës 17.03.2021

Sekretarja juridike
Lulavere Mala

Kryetari i trupit gjykues
Sami Sharaxhiu

UDHËZIM JURIDIK

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa
Në afat prej 15 ditësh , nga dita e pranimiit
Gjykatës së Apelit në Prishtinë e përmes kësaj gjykate .